



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 04.11.2019)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Raport mbi informacionin periodik të Kryetarëve të Gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore, për periudhën prill – qershor 2019, relatore znj. Brunilda Kadi.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:08 dhe mbaroi në orën 12:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoreshë pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
6. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
7. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
8. *Klodian Rado, EURALIUS.*
9. *Gregor Borkowski, EURALIUS.*
10. *Ervin Karamuço, ISP.*
11. *Arlind Maloku, QE.*
12. *Përfaqësues të medias (Kameramanët prezent vetëm në prezantimin e rendit të ditës. Ndërsa gazetarët prezent vetëm në pikën e parë dhe të dytë.)*

RENDI I DITËS:

1. Raport mbi informacionin periodik të Kryetarëve të Gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore, për periudhën prill – qershor 2019, relatore znj. Brunilda Kadi.

Naureda Llagami: Atëherë, përshëndetje!

Siç jeni në dijeni, sot do zhvillojmë mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor, të datës 04.11.2019. Të gjithë anëtarët janë të pranishëm.

Ashtu sikurse jeni vënë në dijeni tek rendi i ditës, sot në diskutim, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, do të merren 6 çështje.

Çështja e parë ka të bëjë me Raportin mbi informacionin periodik të kryetarëve të gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore, për periudhën prill – qershor 2019.

Çështja e dytë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e pjesëmarrjes së magjistratëve në programin e trajnimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës për periudhën tetor – dhjetor 2019”.

Çështja e tretë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 112, datë 09.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor” (që ka lidhje me magjistratët udhëheqës).

Çështja e tjetër e rendit të ditës ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit, të gjyqtarit {...}, për shkak të dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit”.

Çështja tjetër ka të bëjë me miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor për datat respektive 11 tetor, 17 tetor dhe 22 tetor.

Çështja e fundit ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjorë të kandidimit për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, të kandidatit z. {...}”.

Nëse jeni dakord me rendin e ditës?

Dakord.

Atëherë, për të vijuar mbledhjen ia jap fjalën relatores së çështjes së parë që është zonja Kadi. Ndërkohë që i kërkoj kameramanëve të vazhdojnë dhe gazetarët të ulen pranë ambienteve të Këshillit, për të vazhduar mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

(Kameramanët dalin nga salla e mbledhjes.)

Atëherë, ia japim fjalën zonjës Kadi, për të na informuar lidhur me raportin periodik të kryetarëve të gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore, për periudhën prill-qershor 2019. Faleminderit!

Brunilda Kadi: Faleminderit, Kryetare!

Atëherë, për tremujorin e dytë, nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale është përpunuar informacioni që ka ardhur nga kryetarët e gjykatave për tremujorin prill-qershor 2019. Të gjithë statistikat ju janë njoftuar anëtarëve dhe një memo, që është një përmbledhje e të gjithë informacionit që ka ardhur, nga specialistja ju është nisur. Ndërkohë ne si Komision kemi përpiluar një raport përmbledhës, duke evidentuar problemet nga informacioni që vlerësohet nga ne kryesor dhe disa nga propozimet që kemi si Komision në lidhje me zgjidhjen e disa situatave.

Atëherë, bazuar në vendimin nr. 25 të datës 07.02.2012 (*lapsus viti, pasi është 2019*), ku Këshilli ka miratuar llojin e informacionit që do sillnin kryetarët e gjykatave në

lidhje me veprimtarinë gjyqësore dhe vendimi 115, me të cilin Këshilli miratoi edhe formularin tip sipas të cilit do të dërgohej ky informacion, është sjellë, për periudhën që u citua më lart, informacioni nga të gjithë gjykatat (nga 38 gjykatat).

Në lidhje me pikën e parë të këtij informacioni, që ka të bëjë me ngarkesën e çështjeve për gjykatë dhe gjyqtar, për evidentimin e çështjeve të mbartura apo numrin e çështjeve të zvarritura tej afateve të arsyeshme, është sjellë, për çdo nga gjykatat, informacioni. Në lidhje me këtë të dhënë, nga raportimet e sjella u konstatua që një numër i konsiderueshëm i gjykatave, 31 nga 38, i kishin përcjellë statistikave pothuajse tërësisht gabim, pasi sipas formatit tip të miratuar nga Këshilli, të dhënat për çështjet e mbartura dhe të regjistruara me ato të gjykuara dhe ato në shqyrtim, nuk përputheshin. Për këtë është komunikuar nëpërmjet telefonit me të gjithë kancelarët e të gjitha gjykatave që kishin këto probleme, me qëllim që të shpjegohej më qartësisht mënyra e plotësimit të tyre dhe për të ridërguar edhe njëherë këto të dhëna nëse kishte mundësi dhe qëllimi tjetër ishte që tremujorin pasardhës mos të përsëritej e njëjta situatë. Nga ky komunikim rezultoi se arsyeja e kësaj pasaktësie ka qenë moskuptimi nga ana e kancelarëve të të dhënave që duhet të dërgonin, por edhe nga fakti që këto të dhëna nuk gjenerohen nga sistemi automatikisht, por bëhen manualisht.

Ndërkohë, nga këto 31 gjykata që kishin probleme vetëm 5 prej tyre nuk kanë reaguar ose i kanë ridërguar gabim këto statistika, e që ishin konkretisht: Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, ajo e shkallës së parë Tiranë administrative, e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe e Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Nga ana e Komisionit, në lidhje me këtë situatë propozohet së pari, ndoshta do ishte e nevojshme trajnimi i kancelarëve për mënyrën e përpilimit të statistikave në lidhje me çfarë do të konsiderohen çështjet e mbartura, çështjet e regjistruara, çështjet e gjykuara, çështje në shqyrtim; një unifikim të mënyrës së regjistrimit manualisht të çështjeve nga gjykatat deri në momentin e implementimit të një sistemi elektronik të uniformizuar të menaxhimit të çështjeve; përfshirjen në statistika të çështjeve të pezulluara.

Nga ana tjetër, një sugjerim që bëhet nga ana e Komisionit tonë është që, Komisioni përgjegjës ose vetë Këshilli, nëse do jetë e njëjta situatë, po me të njëjtat

gjkata dhe kancelarë, mbase ka vend për të tërhequr vëmendjen dhe për të ecur më tutje edhe me ndonjë masë disiplinore ndaj kancelarëve sepse nuk është e justifikuar situata.

Në lidhje pastaj me ngarkesën e çështjeve gjyqësore për gjykatë e çdo gjyqtar konstatohet që gjykatat japin informacionin si më poshtë dhe ju e keni në relacion, që mos të ndalemi tek secila gjykatë për numrin e çështjeve.

Ajo që bie në sy, siç të gjithë e dimë, është Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës. Përveçse ka një ngarkesë shumë të madhe, ka një tregues pothuajse të pashpjegueshëm të shpërndarjes së ngarkesës midis gjyqtarëve, e konkretisht: Kryetarja e Gjykatës ka një ngarkesë 65 çështje, ndërkohë që gjyqtarët e tjerë kanë 5-fishin e saj.

Po kështu edhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë ka një ngarkesë mesatare për gjyqtar 86 çështje, ndërsa ajo e tremujorit të parë ka qenë 404 çështje. Por kjo mund të jetë edhe çështje e dërgimit të statistikave.

Gjirokastra, ka edhe kjo probleme me statistikën, siç e keni tek relacioni. Ka një mesatare 70 çështje për gjyqtar. Ndërkohë që mungon ajo e tremujorit të parë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër ka një ngarkesë mesatare për gjyqtar 945 çështje dhe në fakt, këto janë çështje të regjistruara në total në këtë gjykatë, ku ka vetëm një gjyqtar në detyrë, -siç e kemi të qartë situatën e Shkodrës. Dhe me radhë tani, s'po i lexoj këto statistikat. Tabelat i keni tek relacioni.

Për gjykatën e lartë, siç e dimë, që vazhdon situata dhe backlogu ka shkuar (deri ditën e informacionit të përcjellë) 32.106 çështje.

Për sa i përket përmbajtjes së këtyre të dhënave, ashtu si edhe në tremujorin e parë, edhe në këtë tremujor, në lidhje me ngarkesën e çështjeve gjyqësore për gjykatë dhe çdo gjyqtar, konstatohet se: Gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Përmet, Pukë, Mat, Korçë, ngarkesa është rreth 60 çështje për gjyqtar; gjykatat e tjera të cilat kanë një numër gjyqtarësh në detyrë më pak se 5, ngarkesa e gjyqtarëve është mbi 120 çështje në shqyrtim; gjykatat e mëdha si ajo e Shkodrës, Tiranës, Vlorë, Fier, Sarandë, Lushnje, Krujë ngarkesa është pothuajse e njëjtë si me tremujorin e parë; ndërsa gjykata e Gjirokastrës, Pogradecit (ato të rrethit gjyqësor), raportojnë ngarkesë më të madhe për gjyqtar këtë 3-mujor të dytë (në krahasim me ç'është bërë).

Gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të posaçëm Korçë, Gjirokastrë dhe Tiranë kanë ngarkese afërsisht të njëjtë; për Administrativen e Shkallës së Parë Durrës, siç u tha ka diferenca të pashpjegueshme, prandaj vlerësohet që t'i merret një informacion kryetares së gjykatës, në kushtet kur nuk është ngritur ILD-ja e cila mbikëqyr mënyrën e ndarjes së çështjeve me short, do t'i kërkonim një informacion në lidhje me arsyet pse janë këto të dhëna, me qëllim për t'u orientuar nëse ka vend për ndonjë përmirësim apo edhe që do na shërbejë si e dhënë kur të draftojmë rregulloren në lidhje me mënyrën e ndarjes me short të çështjeve; ndërsa për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, është normale, duhet të ndërhyhet në mënyrë sa më urgjente për plotësimin e trupës gjyqësore.

Gjykatat e apeleve të juridiksionit të përgjithshëm, ngarkesën më të madhe e ka Gjykata e Apelit Tiranë me 400 çështje për gjyqtar, ndërsa Korça dhe Gjirokastra kanë ngarkesë minimale.

Apelet e juridiksionit të posaçëm, siç dihet problematikë paraqitet gjithë kohës Gjykata e Apelit Administrativ, për të cilën propozohet që t'i kërkohe kryetarit së gjykatës, në kushtet kur nuk është ngritur ILD informacion në lidhje me arsyet pse janë këto të dhëna, - të dhënat i keni bashkëngjitur tek anekset.

Në përmirësimin e kësaj situatë, propozohet përveç plotësimit të vendeve vakante edhe miratimi i rregullave të detajuara për programin dhe procedurat e ndarjes së çështjeve me short sipas pikës 3 të nenit 25 të ligjit për Statusin.

Në lidhje me backlogun e Gjykatës së Lartë në shifrën siç u tha më lart, propozohet marrja e masave paraprake nga KLGJ, të cilat do të ndihmojnë në shqyrtimin e sa më shumë çështjeve në momentin kur Gjykata e Lartë do të jetë funksionale.

Për çështjet e zvarritura tej afateve të arsyeshme nga ato që përcakton neni 399/2 i K.Pr.Civile, gjykatat që kanë një numër të madh të tyre, janë ajo e rrethit gjyqësor Tiranë, me 547 (po këtu duhet të kihet parasysh edhe fakti që është edhe gjykata më e madhe dhe ka një numër më të madh gjyqtarësh); është ajo administrative e apelit Tiranë me 7926 dhe Administrative e Shkallës së Parë Durrës me 398. Kjo shifra mendoj që do jetë përsëri pjesë e gabimit të statistikave, se duhet të jetë më e lartë.

Nga informacioni që jepet nga të gjitha gjykatat, arsyet e zvarritjeve të çështjeve lidhen kryesisht me arsyet procedurale siç janë; pezullimet, marrje provash, letër porosi, vendimmarrje nga Gjykata e Lartë, por edhe ngarkesa e çështjeve. Kjo lidhet më shumë me gjykatat administrative, pra numri i madh i çështjeve që shkojnë në këto gjykata dhe numri i vogël i gjyqtarëve në disa prej tyre.

Në lidhje me respektimin e etikës dhe solemnitetit nga trupa gjyqësore, që është pika e dytë e vendimit, nuk raportohet të ketë problematikë nga asnjë nga gjykatat.

Në lidhje me kërkesat për heqje dorë të miratuara nga kryetari i gjykatës për çdo gjyqtar dhe të vendimeve për përjashtim gjyqtari të pranuar me kërkesë të palëve për shkak të konfliktit të interesit, bashkë me emrin e gjyqtarit të përjashtuar është raportuar nga të gjithë kryetarët dhe konstatohet se ka një numër relativisht të madh të tyre. Shkaku i dorëheqjeve apo përjashtimeve evidentohet vetëm nga një pjesë e gjykatave në fakt, edhe pse sipas formularit të miratuar është kërkuar që të jepen shkaqet që lidhem me to.

Në tremujorin tjetër, se ndërkohë janë sjellë të dhënat për tremujorin korrik-shtator (qershor), përsëri kanë ardhur një pjesë me probleme, por do punohet që të ridërgohen dhe të plotësohen ato pjesë që kanë ardhur me probleme në tremujorin e dytë.

Për sa i përket dorëheqjeve, nga informacioni vihet re një numër shumë i madh i kërkesave për heqje dorë të pranuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, që janë 232 kërkesa dhe ajo e rrethit gjyqësor Vlorë me 171 kërkesa. Arsyeja e këtij numri lidhet me një problem teknik që ka lidhje me sistemin e menaxhimit të çështjeve, ICMIS që përdorin këto gjykata. Sipas shpjegimit të kryetarëve, ky sistem nuk i lejon të përjashtohen paraprakisht nga shorti i gjykimit të themelit të një çështjeje penale, gjyqtarin e hetimit paraprak të po kësaj çështjeje.

Ndërkohë, ajo që vihet re është që gjykatat e tjera që kanë këtë sistem, nuk e kanë këtë problem. Si duket e kanë zgjidhur në mënyra të ndryshme dhe që do iu sugjerohet edhe këtyre gjykatave, që ndoshta të ndjekin praktikën e tyre.

Këtu tek raporti ka disa të dhëna, por ndoshta mungon një informacion në lidhje me këto statistikat e Vlorës, që ka qenë një lapsus nga statistikat që ka sjellë kancelarja, prandaj janë edhe disa shifra që duken si pa lidhje.

Për sa i përket pikës tjetër të vendimit që lidhet me funksionimin e sistemit të regjistrimit audio, niveli i përdorimit të tij nga secili gjyqtar, është si edhe tremujorin e kaluar. Vihet re që ka diferenca të mëdha midis disa gjykatave. Në raportim nuk jepen shumë shpjegime për arsyet e mospërdorimit, por nga ajo që kuptohet, shkaku kryesor i përqindjes së ulët është mungesa e sallave. Edhe në lidhje me këtë situatë është i njëjti sugjerim që është bërë tremujorin e kaluar, duhet të shikohet mënyra se si mund të ndërhyhet sa më shpejt në infrastrukturë dhe nga gjykatat më problematike, siç ishte edhe herën e kaluar, është ajo e rrethit gjyqësor Tiranë që e ka shumë të ulët numrin e seancave të zhvilluara audio (rreth 18%), ndërkohë që pjesa më e madhe e gjykatave, sidomos ato të vogla është gati 100%.

Për sa i përket informacionit për fillimin e seancave me vonesë, nuk raportohet ndonjë problematikë. Një pjesë e gjykatave që raportojnë disa vonesa, japin edhe arsyet, por që lidhen me shkaqet që nuk varen nga gjyqtarët, që kanë të bëjnë me faktin e zgjatjes së seancave pararendëse, vonesat e paraqitjes së palëve, shoqërimi i të pandehurve, vonesat e avokatëve dhe prokurorëve.

Për sa i përket përdorimit të funksionimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve, së bashku me nevojat e konstatuara për përditësimin e këtij sistemi është e njëjta problematikë si edhe tremujorin e kaluar. Pothuajse të gjitha gjykatat rendisin një sërë problematikash në lidhje me këtë sistem. I keni të detajuara tek anekset që ju janë sjellë, të statistikave.

Për problematikat në lidhje me vonesat në dorëzimin e vendimeve të arsyetuara raportohet kjo e dhënë vetëm nga 19 gjykata, por që nuk raportohet ndonjë rast që të ketë sjellë pasoja për palët.

Për problematikën tjetër të evidentuar, që është pika e fundit që lihet e hapur për kryetarët që të sjellin çdo problematikë tjetër përpara Këshillit për ta bërë prezent, ato i keni të detajuara tek secila nga gjykatat. Nga 38, 20 prej tyre kanë përcjellë një sërë problemesh. Ajo që vihet re nga tërësia e këtyre problemeve është që zgjidhja e shumicës së tyre do të realizohet me hartën e re gjyqësore dhe që edhe për këtë arsye duhet t'i jepet më shumë prioritet për ta përmbyllur sa më shpejt.

Problematikat kryesore, përveç sistemit të menaxhimit të çështjeve, kanë të bëjnë me infrastrukturën në fakt. Ka disa gjykata që thonë që kanë prokurorinë ngjitur, shërbimin e provës, zyrën e përmbarimit, probleme të tjera infrastrukturore, që nëse do realizohej harta, shumë prej tyre do evitoheshin.

Kjo është pak a shumë përmbledhja e këtij informacioni. Faleminderit!

Naureda Llagami: Kemi ndonjë diskutim, ndonjë paqartësi, pyetje?

Atëherë, Këshilli e miraton parimisht informacionin e përcjellë nga Komisioni.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 04.11.2019)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e pjesëmarrjes së magjistratëve në programin e trajnimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës për periudhën tetor – dhjetor 2019”, relatorë znj. Brikena Ukperaj.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:08 dhe mbaroi në orën 12:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. ***Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.***
2. ***Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***
3. ***Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***
4. ***Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.***
5. ***Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.***
6. ***Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.***
7. ***Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.***
8. ***Klodian Rado, EURALIUS.***
9. ***Gregor Borkowski, EURALIUS.***
10. ***Ervin Karamuço, ISP.***
11. ***Arlind Maloku, QE.***
12. ***Përfaqësues të medias (largohen gjatë shqyrtimit të kësaj pike).***

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e pjesëmarrjes së magjistratëve në programin e trajnimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës për periudhën tetor – dhjetor 2019”, relatorë znj. Brikena Ukperaj.

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja e dytë e rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e pjesëmarrjes së magjistratëve në programin e trajnimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës për periudhën tetor-dhjetor 2019”, projekt-akt i të cilit do të relatohet nga zonja Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit, zonja Kryetare!

Të nderuar anëtarë, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka detyrimin e bashkëpunimit të vazhdueshëm me Shkollën e Magjistraturës, si në kuadër të formimit fillestar ashtu dhe

atij vazhdues që kjo shkollë organizon, me qëllim rritjen profesionale të gjyqtarëve. Në këtë kuadër Shkolla e Magjistraturës duke filluar që prej prillit 2019, ka koordinuar dhe ndjekur metoda sistematike e të përshtatshme për vlerësimin e nevojave për trajnim të magjistratëve në përgjithësi. Mendimi në lidhje me përmbajtjen tematike të Programit të Formimit Vazhdues, i është kërkuar paraprakisht edhe Këshillit të Lartë Gjyqësor... Shkolla e Magjistraturës i ka kërkuar paraprakisht mendim Këshillit të Lartë Gjyqësor si dhe çdo gjyqtari dhe pas një konsultimi të gjerë me vendimin e datës 02.07.2019 ka miratuar “Programin e Formimit Vazhdues”, për vitin akademik 2019-2020, e në vijim ia ka dërguar formularin për aplikim çdo gjyqtari në Republikën e Shqipërisë. Në formularin e aplikimit, gjyqtarët kanë aplikuar për temat prioritare, temat të nivelit të dytë dhe temat të nivelit tre dhe pas mbylljes së aplikimeve, në vijim të procedurës, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës ka miratuar edhe kalendarin e aktiviteteve trajnuese për këtë vit akademik 2019-2020.

Në vijim të procedurës, Këshilli Drejtues dhe Shkolla e Magjistraturës i ka kërkuar Këshillit të Lartë Gjyqësor që në zbatim të kompetencave të tij referuar ligjit për organet e qeverisjes së sistemit dhe atij të statusit të miratojë listën e pjesëmarrësve në këto aktivitete trajnuese.

Këshilli i Lartë Gjyqësor investohet në këtë procedurë në zbatim të nenit 272 pika 1 dhe 3 të ligjit që parashikon detyrimin e Këshillit për të miratuar pjesëmarrjen e gjyqtarëve në trajnimin vazhdues sipas programit të përditësuar të këtij formimi dhe këtë listë t’ia dërgojë Shkollës së Magjistraturës; po kështu buron edhe nga neni 88 shkronja /a/ dhe /c/ i ligjit për organet e qeverisjes ku përcaktohet detyrimi i Shkollës së Magjistraturës dhe i Këshillit për të bashkëpunuar lidhur me nevojat për trajnim të gjyqtarëve. Njëkohësisht, Këshilli, parashikohet në këtë dispozitë, është ai autoritet i cili vendos mbi kërkesat e gjyqtarëve për trajnimin vazhdues në Shkollën e Magjistraturës.

Në referim të parashikimeve ligjore, lista e pjesëmarrjes në aktivitete trajnuese, që janë gjyqtarë në detyrë, gjyqtarë të komanduar në funksione të tjera, miratohet nga Këshilli dhe i dërgohet Shkollës së Magjistraturës. Shkolla e Magjistraturës ka edhe një përgjashtim, që për shkak të nevojave për trajnim, mund të përditësojë programin e saj

tematik dhe ndërkohë po kështu edhe listën e pjesëmarrësve në këto trajnime duke njoftuar paraprakisht edhe Këshillin.

Në lidhje me pjesëmarrjen në aktivitetet e trajnimit vazhdues të gjyqtarëve të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës, në ligjin për Statusin, konkretisht në nenin 5, parashikohet detyrimi ligjor i magjistratëve për të ndjekur programin e formimit vazhdues në përputhje me parashikimet e këtij neni (që është neni 5 pika 1 dhe pika.. dhe shkronja /a/) ku parashikohet detyrimi dhe përcaktohen kufijtë minimalë dhe maksimalë të angazhimit në programin e trajtimit vazhdues, përkatësisht jo më pak se 5 ditë të plota në vit dhe jo më shumë se 40 ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë 5 viteve dhe jo më shumë se 200 ditë gjatë 5 viteve; parashikohet mundësia e pjesëmarrjes në programin e trajnimit vazhdues jo vetëm nga Shkolla e Magjistraturës por edhe institucione të tjera në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, të njohura nga KLGJ, me kushtin që aktivitetet trajnuese të vlerësohen të përshtatshme në raport me funksionin e gjyqtarit.

Për sa i përket projektvendimit që po i paraqitet sot për miratim mbledhjes plenare, ai ka 4 pika. Në pikën e parë parashikohet... Në pikën e parë të këtij projektvendimit që paraqitet për miratim është përcaktuar miratimi i listës së gjyqtarëve për të marrë pjesë në aktivitetet e përcaktuara, sipas kërkesave të përcjella prej tyre pranë Shkollës së Magjistraturës.

Komisioni është treguar i kujdesshëm në evidentimin e listës së pjesëmarrësve, pasi kërkesat për aplikim pranë Shkollës së Magjistraturës kanë qenë jo vetëm nga ana e gjyqtarëve por edhe nga ana e të diplomuarve të Shkollës së Magjistraturës për të cilët ende nuk është bërë emërimi i tyre, po kështu edhe nga ana e ndihmësve ligjorë, pra është bërë kujdes në përcaktimin e pjesëmarrjes në Shkollën e Magjistraturës, duke përfshirë të gjithë subjektet aplikues që kanë statusin e gjyqtarit, pavarësisht momentit të aplikimit të kërkesës. Në listat e dërguara nga Shkolla e Magjistraturës kishin aplikuar ndihmës ligjorë, kishin aplikuar edhe dy gjyqtarë të cilët nuk e kanë më tashmë statusin e gjyqtarit për shkak të vendimeve të KLD-së (janë përcaktuar në relacion). Zonja {...} dhe zonja {...} janë përjashtuar nga listat e pjesëmarrësve për shkak sepse me mbarimin e statusit, mbaron detyrimi i tyre i ndjekjes së trajnimit vazhdues. E njëjta logjikë është ndjekur

edhe për sa i përket të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës. Disa prej tyre në fakt janë kualifikuar nga Këshilli, por në kushtet kur nuk kanë përfunduar procedurat e emërimit të tyre, statusi i gjyqtarit prej tyre nuk është fituar. Kjo nuk i penalizon ata në ndjekjen e trajnimeve sepse Shkolla, siç relatuar më lart, ka kompetencën për ta përditësuar në mënyrë të vazhdueshme kalendarin e trajnimeve por edhe pjesëmarrjen e gjyqtarëve në to.

Pika e dytë e projektvendimit - përcakton detyrimin e magjistratëve për të marrë pjesë në sesionet e aktivitetit trajnues sipas rregullave të përcaktuara nga organizatori i aktivitetit, që është në rastin konkret Shkolla e Magjistraturës me detyrimet e hollësishme të parashikuara në rregulloren e kësaj shkolle. Pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe pjesë integrale e këtij vendimi është njëkohësisht edhe lista e cila i bashkëngjitet vendimit me emrat e të gjithë gjyqtarëve, pjesëmarrja e të cilëve është miratuar njëkohësisht edhe me individualizimin e të gjitha aktiviteteve trajnuese të gjyqtarëve.

Në pikën e tretë është parashikuar detyrimi i magjistratëve për të organizuar paraprakisht punën, lidhur me planifikimin e seancave dhe veprimeve që kanë lidhje me gjykimin e çështjeve. Në kushtet kur gjyqtarët njoftohen paraprakisht për miratimin e kërkesës së tyre sipas aktiviteteve me data të përcaktuara, duhet të planifikojnë seancat gjyqësore në mënyrë të tillë që pjesëmarrja të mos jetë shkak për pengesë në ushtrimin e veprimtarive të tyre. Për shkak të organizimit të punës brenda gjykatës ku magjistrati ushtron funksionin, një kopje e vendimit me miratimin e listës së pjesëmarrësve i njoftohet të gjitha gjykatave dhe kryetarëve të gjykatave.

Në pikën e katërt parashikohet detyrimi i njoftimit të vendimit të Shkollës së Magjistraturës, gjykatave apo edhe institucioneve ku gjyqtarët pjesëmarrës ushtrojnë detyrën e gjyqtarit apo detyra të tjera si gjyqtarë të komanduar.

Në vlerësimin e Komisionit, detyrimi i gjyqtarit të respektojë kufijtë ligjorë minimalë dhe maksimalë të pjesëmarrjes në aktivitete trajnuese buron nga ligji (është neni 5, pika 3 e ligjit për Statusin) dhe nuk mund të jetë pjesë përbërëse e vendimmarrjes së mbledhjes plenare, gjithsesi referuar listës së pjesëmarrësve të dërguar për këtë periudhë tremujore është patur parasysh që të bëhet miratimi i një pjesëmarrjeje brenda kufijve të detyrimit ligjor jo më pak se 5 ditë dhe jo më shumë se 40 ditë në vit.

Lidhur me mënyrën e trajtimit financiar të magistratëve lidhur me shpenzimet e nevojshme të udhëtimit dhe akomodimit për shkak të angazhimit në aktivitetet e trajnimit, ligji për Statusin, neni 5, pika 5 e ligjit 96/2016 parashikon se shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit të magistratëve në ndjekje të programit të formimit vazhdues mbulohen nga fondi i miratuar për këtë qëllim nga Shkollën e Magjistraturës ose nga fonde apo burime të tjera të përcaktuara për këtë veprimtari. Për këtë qëllim në miratimin e listës së pjesëmarrjes është mbajtur në konsideratë jo vetëm barazia në trajtimin e kërkesave të gjyqtarëve, por edhe kombinimi i prioriteteve në temat e zgjedhura me shpërndarjen gjeografike të pjesëmarrësve në trajnime.

Duke e konsideruar një akt administrativ kolektiv, ky vendim hyn në fuqi ditën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në referim të nenit 98, pika 3 të ligjit nr.115/2016.

Lidhur me kompetencën e mbledhjes plenare në trajtimin e çështjes konkrete, referuar nenit 61 të ligjit 115/2016 të ndryshuar, Komisioni vlerëson se, ky vendim për miratimin e pjesëmarrjes së gjyqtarëve në trajnimin vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës, në thelb nënkupton pajisjen e gjyqtarëve me leje për ndjekjen e këtyre trajnimeve, sipas pikës 6 të nenit 5 të ligjit. Prandaj, pavarësisht se çështjet që lidhen me trajnimin vazhdues të gjyqtarëve nuk janë kompetencë e mbledhjes plenare, për sa kohë ende nuk ka një vendimmarrje të KLGJ-së në lidhje me procedurën e pajisjes me leje për ndjekjen e trajnimeve vazhduese (pra një akt nënligjor normativ) dhe as është miratuar një rregullore e brendshme e Këshillit për çështjet për të cilat çdo Komision i Përhershëm ka kompetenca vendimmarrëse, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale vlerëson se kjo çështje duhet të miratohet në mbledhje plenare. Bashkëlidhur relacionit është lista e gjyqtarëve pjesëmarrës që janë dërguar nga Shkolla e Magjistraturës, në të cilën janë përjashtuar pikërisht gjyqtarët të cilëve u ka mbaruar statusi, të diplomuarit që nuk e kanë fituar statusin e gjyqtarit dhe ndihmësit ligjorë të cilët nuk e kanë statusin e gjyqtarit.

Projektvendimi që ju përcillet për miratim përmban tre pikat e mësipërme të cilat u relatuan. Është e nevojshme zonja Kryetare ta lexoj apo do ta lexoni ju?

Ky ishte relacioni lidhur me miratimin e pjesëmarrësve në trajnimin vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës.

Naureda Llagami: Atëherë, kemi ndonjë diskutim, propozim konkret?

Atëherë, në qoftë se nuk kemi diskutime, ju lutem, kalojmë në vendimmarrje të projektit të propozuar nga relatorja, sipas propozimit konkret. Vendimmarrje!

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Të miratojë kërkesat e gjyqtarëve për të marrë pjesë në programin e formimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës, për periudhën tetor 2019 – dhjetor 2019, sipas listës së pjesëmarrësve për çdo aktivitet trajnimi bashkëlidhur këtij vendimi e pjesë përbërëse e tij. Gjyqtarët e miratuar sipas pikës 1 të këtij vendimi, marrin pjesë në aktivitetet trajnuese, sipas rregullave të parashikuara në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës. Gjyqtarët duhet marrin masa organizative për të mos penguar ushtrimin e veprimtarisë gjyqësore ose asaj për të cilën janë komanduar, në ditën që do të marrin pjesë në aktivitetin trajnues. Ky vendim i njoftohet Shkollës së Magjistraturës, gjykatave dhe institucioneve të tjera ku gjyqtarët sipas listës së miratuar bashkëlidhur këtij vendimi, ushtrojnë detyra të tjera si gjyqtarë të komanduar. Vendimi hyn në fuqi menjëherë me botimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 04.11.2019)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 112, datë 09.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor” (në lidhje me magjistratët udhëheqës), relatore znj. Brunilda Kadi.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:08 dhe mbaroi në orën 12:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
2. **Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
3. **Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
4. **Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
5. **Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.**
6. **Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**
7. **Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
8. **Klodian Rado, EURALIUS.**
9. **Gregor Borkowski, EURALIUS.**
10. **Ervin Karamuço, ISP.**
11. **Arlind Maloku, QE.**

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 112, datë 09.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor” (në lidhje me magjistratët udhëheqës), relatore znj. Brunilda Kadi.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen e tretë, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 112, datë 09.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor” (e cila ka të bëjë me magjistratët udhëheqës). Edhe për këtë akt, fjalën ia jap zonjës Kadi.

Brunilda Kadi: Faleminderit, Kryetare!

Atëherë, me vendimin 112 Këshilli ka vendosur të përcaktojë magjistratët gjyqtarë udhëheqës për kandidatët për magjistratë, profili gjyqtar, viti akademik 2019-2020, sipas listës bashkëngjitur atij vendimi. Gjatë kësaj kohe, ka ndodhur që dy nga

magjistratët udhëheqës dhe konkretisht gjyqtarja {...} dhe {...} nuk mund të vazhdojnë të bëjnë këtë detyrë pasi gjyqtarja {...} i është deklaruar mbarimi i statusit për shkak të dorëheqjes së motivuar në datë 22.10.2019, me efekt deri ditën e fundit të muajit tetor dhe gjyqtarja {...} me vendimin e datës 22.10. është vendosur të komandohet në pozicionin e pedagogut të brendshëm pranë Shkollës së Magjistraturës me një afat 15-vjeçar (*lapsus, pasi afati është 5-vjeçar*), duke i filluar nga data 15 nëntor 2019. Në këtë situatë, nga Shkolla e Magjistraturës, me shkresën e datës 24.10.2019 i është kërkuar Këshillit të Lartë gjyqësor, zëvendësimi i këtyre dy magjistratëve me udhëheqës të tjerë nga lista që është miratuar me vendimin 112.

Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale ka vlerësuar dhe i propozon mbledhjes plenare zëvendësimin e dy magjistratëve udhëheqës me udhëheqës të tjerë nga lista e miratuar me vendimin 112. Për këtë zëvendësim është e nevojshme dhe propozohet ndryshimi i këtij vendimi. Për sa i përket listës së miratuar, në këtë listë janë përcaktuar për secilin kandidat për magjistrat, profili gjyqtar, magjistratët udhëheqës për secilën nga tre periudhat 4-mujore që kanë mbetur. E konkretisht, sipas projektvendimit, ajo që propozohet është që: 1. Të zëvendësojë magjistratin gjyqtar udhëheqës, znj. {...}, e caktuar për kandidatin për magjistrat, profili gjyqtar, z. {...}, për periudhën mars 2020-qershor 2020, me magjistratin gjyqtar udhëheqës, znj. {...}. 2. Të zëvendësojë magjistratin gjyqtar udhëheqës, znj. {...} (*lapsus mbiemri, pasi mbiemri është {...}*), e caktuar për kandidatin për magjistrat, profili gjyqtar, znj. {...}, për periudhën nëntor 2019 - shkurt 2020, me magjistratin gjyqtar udhëheqës, z. {...}. 3. Të zëvendësojë magjistratin gjyqtar udhëheqës, znj. {...} (*lapsus mbiemri, pasi mbiemri është {...}*), e caktuar për kandidatin për magjistrat, profili gjyqtar, znj. {...}, për periudhën mars 2020 - qershor 2020, me magjistratin gjyqtar udhëheqës, z. {...}. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në lidhje me mbiemrin e zonjës {...}, të saktësohet sepse i ka të dy, është me të dy mbiemrat.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Erjon Muharremaj: Vetëm diçka.

Referuar nenit 6 të ligjit “Për gjendjen civile” prioritet ndaj çdo akti tjetër të administratës kanë të dhënat në shërbimin e gjendjes civile. Reflektuar certifikatës lëshuar nga zyra e gjendjes civile, figuron me mbiemrin {...}, kështu që mendoj që ky mbiemër duhet të përdoret edhe në aktin tonë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në miratim të projekt-aktit me ndryshimin e propozuar nga zoti Muharremaj.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Të zëvendësojë magjistratin gjyqtar udhëheqës, znj. {...}, e caktuar për kandidatin për magjistrat, profili gjyqtar, z. {...}, për periudhën mars 2020 - qershor 2020, me magjistratin gjyqtar udhëheqës, znj. {...}. 2. Të zëvendësojë magjistratin gjyqtar udhëheqës, znj. {...}, e caktuar për kandidatin për magjistrat, profili gjyqtar, znj. {...}, për periudhën nëntor 2019 - shkurt 2020, me magjistratin gjyqtar udhëheqës, z. {...}. 3. Të zëvendësojë magjistratin gjyqtar udhëheqës, znj. {...}, e caktuar për kandidatin për magjistrat, profili gjyqtar, znj. {...}, për periudhën mars 2020 - qershor 2020, me magjistratin gjyqtar udhëheqës, z. {...}. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 04.11.2019)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit, të gjyqtarit {...}, për shkak të dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:08 dhe mbaroi në orën 12:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
6. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
7. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
8. *Klodian Rado, EURALIUS.*
9. *Gregor Borkowski, EURALIUS.*
10. *Ervin Karamuço, ISP.*
11. *Arlind Maloku, QE.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit, të gjyqtarit {...}, për shkak të dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës e cila ka të bëjë me projektvendimin për mbarimin e statusit të magjistratit, të gjyqtarit {...} për shkak të dorëheqjes së tij nga detyra. Relatimi i këtij projekt-akti do të bëhet nga zonja Shehu.

Marçela Shehu: Po! Faleminderit, Kryetare!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës paraqet përpara jush projektvendimin dhe relacionin përkatës lidhur me deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, konkretisht për gjyqtarin e Gjykatës së Apelit Tiranë zotin {...}, duke paraqitur rrethanat si më

poshtë: Gjyqtari {...} rezulton të jetë aktualisht gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Me shkresën nr. 4321 prot., datë 04.09.2019, ky gjyqtar, ka paraqitur një deklaram dhe kërkesë para Këshillit të Lartë Gjyqësor me objekt: Deklarimin e dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Tiranë; Deklarimin e dorëheqjes nga funksionet e magjistratit në Republikën e Shqipërisë dhe; Kërkesë për deklaramin prej Këshillit të Lartë Gjyqësor të mbarimit të statusit të magjistratit, për shkak të dorëheqjes.

Kjo kërkesë e zotit {...} është e bazuar në nenin 64 e 65 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku konkretisht në nenin 64 të këtij ligji rregullohen rastet e mbarimit të statusit të gjyqtarëve, ndërsa në nenin 65 rregullohet në mënyrë specifike dorëheqja, si një nga rastet e mbarimit të statusit të magjistratit.

Bazuar në këto rrethana, në lidhje edhe me parashikimet ligjore të nenit 64 dhe 65 të ligjit të sipërcituar, Komisioni vlerëson se në rastin konkret jemi në kushtet e mbarimit të statusit të magjistratit të gjyqtarit {...}, për shkak të dorëheqjes së paraqitur prej tij përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kjo dorëheqje ka krijuar efekte ligjore më datë 31.10.2019, pra në fund të muajit pasardhës nga dita kur Këshilli ka marrë deklaramin me shkrim të dorëheqjes, pra nga data 04.09.2019.

Në këto kushte, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor: Të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit të gjyqtarit {...} për shkak të dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit. Efektet ligjore të dorëheqjes fillojnë më datë 31.10.2019. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Shehu!

Kemi ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin e propozuar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga Komisioni.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Apelit Tiranë, për shkak të dorëheqjes së tij nga ky status. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 31.10.2019. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 04.11.2019)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave: 11.10.2019, 17.10.2019 (dy mbledhje), dhe 22.10.2019.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:08 dhe mbaroi në orën 12:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 10. Erjon Muharremaj | (anëtar) |
| 11. Marçela Shehu | (anëtare) |

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. ***Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.***
2. ***Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***
3. ***Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***
4. ***Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.***
5. ***Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.***
6. ***Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënive me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.***
7. ***Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.***
8. ***Klodian Rado, EURALIUS.***
9. ***Gregor Borkowski, EURALIUS.***
10. ***Ervin Karamuço, ISP.***
11. ***Arlind Maloku, QE.***

RENDI I DITËS:

5. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave: 11.10.2019, 17.10.2019 (dy mbledhje), dhe 22.10.2019.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës e cila është miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit për datat 11.10, 17.10. dhe 22.10.

Siç jeni në dijeni, jua kemi shpërndarë. Kështu që, ju lutem, kalojmë në votimin e tre procesverbaleve. Atëherë, për dy procesverbalet e datës 11 dhe 17, unë Kryetarja, zonja Brunilda Kadi dhe Erjon Muharremaj nuk kanë qenë pjesëmarrës, ndërkohë që do votojmë për datën 22.10.

Atëherë, kalojmë me datën 11, ku në këtë datë nuk ka qenë zoti Erjon Muharremaj. Miratimi?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

(Zoti Muharremaj nuk voton për shkak se nuk ka marrë pjesë në këtë mbledhje.)

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Kalojmë me miratimin e procesverbalit të datës...

Pro, për datën 11.

Kalojmë me miratimin e procesverbalit të datës 17.

Maksim Qoku: Dakord.

(Zonja Kadi nuk voton për shkak se nuk ka marrë pjesë në këtë mbledhje.)

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

(Zoti Muharremaj nuk voton për shkak se nuk ka marrë pjesë në këtë mbledhje.)

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

(Gjithashtu edhe zonja Llagami nuk voton për shkak se nuk ka marrë pjesë në këtë mbledhje.)

Naureda Llagami: Kalojmë me procesverbalin e datës 22.10.2019.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 11.10.2019, 17.10.2019 (i pari është i orës 10:20 dhe mbledhja tjetër është e orës 14:00) dhe procesverbalin e datës 22.10.2019. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e këtyre procesverbaleve Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor